



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 27.
Prishtinë, më 27 Korrik 2009, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla Nr - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Adem Hajdaraj ,
Armend Zemaj , Kolë Berisha, Selvije Halimi dhe Vladimir Todoroviq

Munguan: Adem Salihaj, Ibrahim Makolli dhe Mufera Shenik.

Të pranishëm: Isuf Zejna – KDI, Jetulla Aliu dhe Mentor Borovci – Agjencia Kunder
Korrupsionit, Lendita Kastrati – EU – AC, David Wolstenholne – EU-AC, dhe Visar
Krasniqi – Kuvendi i Kosovës.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13 korrikut 2009;
3. Shqyrtimi i propozimit për zgjedhjen e
- 4 .Shqyrtimi i projekt - strategjisë kundër korrupsionit 2009 – 2011 dhe projekt – plani i veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës kundër korrupsionit 2009 – 2011
5. Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës së Pavarur të Veprimtarive Komunale dhe Banesore të Kosovës,
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari I përshëndeti të pranishmit , përfaqësuesit e Agjencisë Kundër korrupsionit, të Zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian, si dhe të atyre që e monitorojnë punën e Komisionit. Propozoi të fillojë shqyrtimi sipas rendit të ditës. Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13 korrikut 2009

Kryetari i pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë vërejtje rreth procesverbalit. Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit për zgjedhjen e anëtareve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Armend Zemaj - propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit.

Adem Hajdaraj – duke u ndërlidhur me parafolësin - propozoi që me shkresë të kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të sjellë propozime të reja, në mënyrë që në shtator të shqyrtohen në Komision.

4 .Shqyrtimi i projekt - strategjisë kundër korrupsionit 2009 – 2011 dhe i projekt – planit të veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës kundër korrupsionit 2009 – 2011

Kryetari – duke iu referuar projekt- strategjisë shtoi se kësaj projekt - strategjie iu ka bashkangjitur edhe Plani i Veprimit. Kjo ishte arsyeja që Kuvendi ka bërë vërejtje pse projekt-strategjia nuk e ka të bashkangjitur edhe Planin e veprimit. Në vazhdim shtoi se projekt - strategjia i përmban pjesët kryesore , me disa vërejtje dhe si e tillë mund të miratohet në parim . Ndërsa duke iu referuar Planit të veprimit tha se është plan i mirë, sepse kur të merret parasysh se të gjitha institucionet kanë për detyrë të kenë Plan të veprimit në momentin kur hartohet strategjia. Lidhur me këtë pikë hapi debat.

Armend Zemaj – në diskutimin e tij ngriti çështjen e afateve kur Plani i veprimit do të vihet në zbatim dhe si parashihet mundësia të shtyhet ky zbatim. Shtoi se edhe Ligji për pagat e zyrtarëve të lartë publikë është tërhequr. Kjo do të thotë se edhe zbatimi i tij do të shtyhet.

Lidhur me këtë pikë diskutuan edhe përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe përfaqësuesit e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian.

Pas një diskutimi që u zhvillua ishte konstatim i përgjithshëm se Projekt - strategjia kundër korrupsionit 2009 – 2011 dhe Plani i veprimit miratohen në parim dhe procedohet për Kuvend për shqyrtim dhe miratim në njërën nga seancat e radhës.

5 . Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës së Pavarur të Veprimtarive Komunale
dhe Banesore të Kosovës

Kryetari – propozoi që shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës t'i bartet Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore Persona të Pagjetur dhe Peticione- si komision funksional.

6. Te Ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati debat.

Procesverbalin e hartoi Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni